



Tiranë më

Nr.

prot.

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE DHE TË MONITORËVE PËR SHFAQJEN E FLETËVE TË VOTIMIT NË VENDIN E NUMËRIMIT TË VOTAVE BRENDA DHE JASHTË VENDIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Bazuar në nenet 20, pika 2, shkronja “c”, nenit 22, pika 2, nenit 23, pika 1, nenit 25/2, nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projekt akteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për mbulimin e aspekteve apo procedurave të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Referuar nenit 22, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sisteme video monitorimi në qendrat e votimit, si dhe kur bëhet numërimi manual i votave, në VNV-të, për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre. Sistemi i video monitorimit nuk mund të instalohet në qendrat e votimit në mënyrë të tillë që të cenojë ose të rrezikojë kryerjen në fshehtësi të votimit. Nëse nuk e kryen vetë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të prokurojë instalimin ose edhe operimin e sistemit të video monitorimit.



Referuar nenit 22, pika 3 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat për aspektet e veçanta të procesit, që mbulohen nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Rregullat procedurale për këtë qëllim miratohen me akt normativ të KQZ-së.

Referuar nenit 25/2, pika 6 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator me propozimin e Komisionerit, përcakton me akt nënligjor dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij dhe çdo aspekt tjetër për administrimin, *vëzhgimin e procesit të numërimit, numërimin, vlerësimin e votës dhe tabelimin e rezultatit zgjedhor sipas këtij neni.*

Gjithashtu referuar të vendimit të Komisionit Rregullator nr 1 date 25.01.2023 “Për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” janë përcaktuar në mënyrë të detajuar rregullat procedurale sipas të cilave do të funksionoj përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve në vendet e numërimit të votave.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për Përdorimin e Kamerave Regjistruese dhe të Monitorëve për Shfaqjen e Fletëve të Votimit në Vendin e Numërimit të Votave brenda dhe jashtë vendit, për Zgjedhjet për Kuvend, të Datës 11 maj 2025”.

Daniela ALIMEMETI – Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Jona JOSIFI – Drejtorja e Votimit nga Jashtë

Pavlina DOÇAJ – Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (AD INTERIM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data:2025

Nr:

Ora:

VENDIM
PËR

PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE DHE TË MONITORËVE
PËR SHFAQJEN E FLETËVE TË VOTIMIT NË VENDET E NUMËRIMIT
TË VOTAVE BRENDË DHE JASHTË VENDIT, NË ZGJEDHJET PËR
KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 399, datë 05.12.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvend”, nenit 20, pika 2, shkronja “c”, nenit 22, pika 2, nenit 23, pika 1, nenit 25/2, nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në çdo vend të numërimit të votave brenda dhe jashtë vendit, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave brenda dhe jashtë vendit nga çdo vend i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve), dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga çdo vend i numërimit të votave brenda dhe jashtë vendit, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ nga Komisioni Rregullator.
4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data:..2025 Nr:
Ora:



“Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilijana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar